

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	E drejta biznesore
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I-rë, semestri I-rë
Numri i orëve në javë:	2 + 1
Vlera në kredi – ECTS:	4 ECTS
Koha / lokacioni:	Sipas orarit
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr. Armand Krasniqi; Diamanta Sojeva
Detajet kontaktuese:	armand.krasniqi@uni-pr.edu ; diamanta.sojeva@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Njohuri për të drejtën dhe rregullimin juridik të biznesit. Programi shpjegohet nëpërmes njësive që kanë të bëjnë për kategoritë themelore për të drejtën dhe shtetin, objektin dhe subjektet e të drejtës biznesore, punët e vlefshme dhe jo të vlefshme juridike, marrëdhëniet kontraktuale – kontratat, të drejtën e shoqërive tregtare, llojet shoqërive tregtare e ndërmarrjeve tjera, bankat dhe sistemin bankar, pronësinë industriale dhe letrat me vlerë.
Qëllimet e lëndës:	Kursi synon që t'i përgatis studentët për operim më të në kuadër të biznesit duke i bërë më të shkathët në sferën e regjistrimit të një forme të caktuar juridike të biznesit si dhe aspekte e marrëdhënieve kontraktuale. Në veçanti qëllimi themelor ka të bëjë me njohjen e detyrimeve që kanë subjekte e të drejtës së kuadër të të gjitha marrëdhënieve juridike me karakter biznesi. Thjeshtë, njohja dhe respektimi i aspektit të ligjit në marrëdhëniet biznesore.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Në fund studentët do jenë të aftë të kuptojnë që: • Rolin dhe funksionin e shtetit dhe të drejtës në përgjithësi në jetën shoqërore – ekonomike dhe konkretisht në sferën e rregullimit të biznesit; • Llojet, fuqinë dhe efektin e normave shoqërore lidhur me sistemin juridik; • Ndërturjen dhe rregullimin e sistemit ekonomik – juridik lidhur me sjelljen e subjekteve të biznesit dhe zbatimin në praktikë të normave juridike;

	- Burimet e detyrimeve me theks të veçantë strukturën, llojet dhe tipet e kontratave biznesore; - Ndërmarrjet biznesore, llojet dhe tipet e tyre, institucionet për mundësinë e regjistrimin dhe shuarje e tyre, dhe aktet juridike të ndërmarrjeve, kontratat dhe llojet e kontratave etj - Sistemin e të drejtës për pronën intelektuale – të drejtën industriale, të drejtën e autorit dhe të drejtët e përafërta.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	13	26
Ushtrime teorike/laboratorike	1	13	13
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	/	/	/
Teste - Kollokfiume,	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			40
Përgatitja përfundimtare për provim		1	
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	/	/	/
Projektet, prezentimet ,etj	1	2	2
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, diskutim ne klase, prezantim dhe debat i punimeve seminarike.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi do të jetë më shkrim. Formulimi do të bëhet prej materialit mësimorë që ligjërohet në sallë dhe forma e tyre do të jetë e kombinuar (opsionale dhe pyetje të shkurtra në formë të eseve). Mënyra e vlerësimit: Zhvillimi dhe prezantimi i punimit seminarik,		

	10% te notes finale; • Dy teste përfaqësojnë 90% te notës finale. • Testi i pare përfshinë rreth 45% të materialit mësimor; • Testi i dytë përfshinë 45% të notës finale. • Prandaj, nëse kalohen dy testet, dhe nëse jeni te rregullt dhe aktiv në ligjërata, si dhe nëse zhvilloni punimin seminarik, nuk ka nevojë që t'i nënshtroheni testit final. Nëse studentja / i, dështon që t'i nënshtrohet njërit nga testet atëherë do t'i nënshtrohet provimit përfundimtar – final. Po ashtu, edhe studentët që kanë hyrë në të dy testet dhe të cilët nuk kanë arritur që t'i grumbullojnë 51% të pikëve dhe studentët që nuk janë të kënaqur me rezultatin e arritur gjatë semestrit duhet t'i nënshtrohen provimit përfundimtar. Testi final: për te kaluar testin e përgjithshëm, studentet duhet që te arrijë së paku 51% të pikëve të parapara.
Literatura	
Literatura bazë:	Dr. Armand Krasniqi "E drejta Biznesore" Edicioni i tretë – CSARA 2019.
Literatura shtesë:	Sipas nevojës, në formë elektronike ose në fotokopje, gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve, do të shpërndahen edhe materiale të ndryshme në lidhje me problemet aktuale zhvillimore. Rekomandohet literature e publikuar në gjuhë angleze që ka të bëjë më të drejtën biznesore dhe përdorim të publikimeve të ndryshme në formë elektronike, posaçërisht me rastin e përgatitjes së punimeve seminarike.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Prezantimi i programit – Shteti, nocioni dhe karakteristikat shtetit dhe të drejtës, Rendi juridik dhe sistemi Juridik, Marrëdhëniet juridike, Faktet Juridike
Java e dytë:	Normat zakonore, morale dhe juridike; Llojet e normave juridike; Hyrje në të drejtën Biznesore , Objekti, Kuptimi, Metodat, Parimet e rregullimit të së drejtës biznesore

Java e tretë:	Burimet e të drejtës biznesore, Burimet juridike materiale dhe formale; Kushtetuta, Ligji, Marrëveshjet ndërkombëtare (konventat), Aktet nënligjore, Aktet e përgjithshme të ndërmarrjeve dhe shoqërive, Zakonet, Uzansat , Kushtet e përgjithshme të biznesit, Precedentët
Java e katërt:	Subjekte e të drejtës biznesore Personat fizikë, Personat Juridikë Objekti i marrëdhënieve biznesore; Punët juridike; Elementet e punës juridike; Përfaqësim
Java e pestë:	E drejta e detyrimeve; Kontratat; Kuptimi dhe ndarje e kontratave; Lidhja e kontartës dhe elemente e saja; Kontratat elektronike
Java e gjashtë:	Shkaktimi i dëmit; Efektet e detyrimeve; Llojet e ndryshme të detyrimeve; Shuarja e detyrimeve
Java e shtatë:	Testi 1
Java e tetë:	E Drejta statusore: Subjektet biznesore dhe shoqëritë tregtare; Format juridike biznesore;
Java e nëntë:	Shoqëria e partneritetit – ortakërisë; Shoqëria komanditore
Java e dhjetë:	Shoqëria më përgjegjësi të kufizuar; Shoqëria Aksionare;
Java e njëmbëdhjetë:	Ndërmarrja publike; Ndërmarrja shoqërore; Ndërmarrja individuale; Kooperativat
Java e dymbëdhjetë:	Ndërlidhja dhe riorganizimi i shoqërive biznesore dhe Shuarja e shoqërore biznesore dhe ndërmarrjes individuale, Likuidimi, falimentimi dhe riorganizimi
Java e trembëdhjetë:	Prona industriale, E drejta e autorit e dhe të drejtat tjera të përafërta
Java e katërmbëdhjetë:	Njohuritë themelore mbi rregullat e letrave me vlerë; Çeku, kuptimi dhe karakteristikat Kambali, kuptimi dhe karakteristikat; Kartelat kreditore, llojet dhe karakteristikat; Letrat legjitimuese dhe shenjat
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Cakto politikat e mirësjelljes në përputhe me statusit të UP-së dhe aktet tjera të rëndësishme.